



E mërkurë, 5 nëntor 2008
ref. 06/008

Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (EUSR), Pieter Feith përshëndet Raportin e Progresit dhe strategjinë e Zgjerimit për Kosovën të vitit 2008

Me rastin e publikimit të Raportit të Progresit për vitin 2008 nga ana e Komisionit Evropian, Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (EUSR), Pieter Feith, lëshon këtë deklaratë:

“Raporti i Progresit i Komisionit Evropian që është publikuar sot është një mjet i rëndësishëm për vlerësimin e progresit të gjithmbarshëm të Kosovës në bërjen e reformave të nevojshme. Ky raport rithekson porosinë se edhe Kosova bën pjesë në perspektivën evropiane të mbarë rajonit. Nëpërmjet këtij raporti po ashtu vihen në pah edhe fushat për të cilat nga autoritetet vendore kërkohet angazhim i rritur dhe i vazhduar, në mënyrë që kjo perspektivë të shndërrohet në realitet.

Unë e mirëpres propozimin e Komisionit Evropian për të bërë një studim fizibiliteti me të cilin do të vlerësohen mënyrat për të çuar përpara zhvillimin politik dhe socio-ekonomik të Kosovës. Ky studim është një lajm i mirë për Kosovën, meqë do të krijojë ide se si Kosova, si pjesë e rajonit, do të mund të ecte më së miri drejt integritit të saj në BE. Në këtë kuptim, unë i inkurajoj institucionet përkatëse të Kosovës që të ndërmarrin reformat e nevojshme.”

(përfundon)

Njoftim për redaktorë:

Për informata të më tutjeshme rreth Raportit të Progresit për Kosovën të vitit 2008 dhe dokumenteve tjera përkatëse, ju lutem t'i referoheni faqes së internetit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë: <http://www.delprn.ec.europa.eu/>